

BMB

Bundesministerium
für Bildung

Mirë se vini
në shkollën
austriake!

Albanisch

Welcome to the Au
the Austrian scho
Bienvenue à l'école
à l'école autrichien
Bine atë venit la șco
it la școala austriac
المدرسة النمساوية
حياكم في المدرسة
Добро пожаловать в ав
вать в австрийскую шко
Willkommen in der österr
der österreichischen Sch
Добре дошли в австри
в австрийското училищ
Avusturya okuluna
okuluna nos geldin
Ku soo dhawow nidaamka
nidaamka dugsiya Austri
ب اتریش خوش آمدید
سیستم مکاتب از اتریش
Mirë se vini në shko
ne shkollën austriak
Марша дог1 ийла шу ав

Të dashur prindër!

Të dashur kujdestarë ligjorë!

Ju keni vetëm pak kohë që keni ardhur në Austri. Shumë gjëra këtu janë të reja për ju – duke përfshirë edhe sistemin arsimor austriak. Për këtë arsye, Ministria e Arsimit ju ofron disa informacione thelbësore për ndjekjen e shkollës në Austri. Stafi mësimor në shkollën e fëmijës suaj është i gatshëm t'u përgjigjet pyetjeve tuaja dhe mund t'ju këshillojë.

1 A lejohet fëmija im të shkojë në shkollë?

Të gjithë fëmijët e moshës 6 deri në 15 vjeç, të cilët jetojnë në Austri, duhet të ndjekin shkollën, d.m.th. janë në moshën **e arsimit të detyrueshëm**. Ky rregull vlen edhe për fëmijët e azilkërkuesve dhe të refugjatëve.

Ndjekja e shkollës në shkollat publike ofrohet falas. Ka gjithashtu edhe shkolla private, për të cilat duhet të paguash.

Ju duhet ta regjistroni fëmijën në shkollën që i përket vendit ku jetoni. Shkoni bashkë me fëmijën tuaj te **regjistrimi në shkollë** dhe merrni me vete edhe një përkthyes, nëse nuk kuptoni dhe nuk flitni vetë akoma mirë gjermanisht. Në një ftesë nga autoriteti arsimor i landit/ autoriteti arsimor i qytetit për Vjenën, ju do të mësoni se kur bëhet regjistrimi në shkollë dhe çfarë dokumentesh duhet të merrni me vete

Fëmija do të marrë një orar mësimi, ku tregohet saktësisht sesa orë zgjat mësimi çdo ditë. Nëse ndodh që fëmija të sëmuret, ju duhet të njoftoni në shkollë. Ju duhet të vini me çdo kusht në mbledhjet me prindër – mund të merrni me vete edhe një përkthyes. Këtu do të merrni informacione të rëndësishme!

Në përfundim të një semestri të gjithë nxënësit marrin një fletë informuese nga shkolla dhe në përfundim të vitit shkollor marrin dëftesë. Rezultatet e nxënësve vlerësohen me nota nga 1 deri te 5. 1 është nota më e mirë dhe 5 është nota më

e keqe. Fëmijët që nuk kuptojnë dhe nuk flasin akoma mirë gjuhën gjermane nuk vlerësohen me notë. Shumë shkolla fillore nuk i vlerësojnë fëmijët me nota, por e përshkruajnë me fjalë ecurinë e fëmijëve me mësimet.

2 Kush e ndihmon fëmijën tim për mësimin e gjermanishtes?

Në varësi nga moshë që ka, fëmija juaj caktohet në një klasë. Fëmijët me gjuhë amtare të ndryshme e zhvillojnë mësimin bashkë.

Fëmijët në moshën e arsimit të detyrueshëm, por që nuk dinë apo dinë shumë pak gjermanisht pranohen në shkollë me statusin e ashtuquajtur **nxënës jo të zakonshëm**. Ata kanë dy vjet kohë që të përvetësojnë njohuritë bazë të gjuhës gjermane. Gjatë kësaj kohe ata përsëri nuk vlerësohen me nota, por megjithatë mund të kalojnë në nivelin arsimor pasardhës.

Nxënësit jo të zakonshëm mund të marrin pjesë në të ashtuquajturin **kurs për mësimin e gjuhës**. Pas kësaj, ata marrin mësim intensiv të gjuhës gjermane – ose në grupe të vogla, ose në klasë me ndihmën e një mësuesi të 2 -të.

Shumë shkolla ofrojnë gjithashtu edhe **mësim në gjuhën amtare**. Për të përfituar, ju duhet ta regjistroni fëmijën tuaj. Mësimi zhvillohet kryesisht në një dy orësh gjatë pasdites. Pyetni nëse në shkollën që frekuenton fëmija juaj apo në ndonjë shkollë afër saj ofrohet mësim në gjuhën amtare të fëmijës.

3 A duhet t'i blejmë vetë librat e shkollës?

Jo. Kjo për faktin se në kuadër të **aksionit për tekstet shkollore**, të gjithë fëmijët i marrin falas librat e shkollës për të gjitha lëndët. Fëmijët që flasin dy gjuhë mund të marrin edhe libra për gjermanishten si gjuhë e dytë, si dhe fjalorë dygjuhësh. Kur fëmija juaj e zhvillon mësimin në gjuhën e tij amtare, ai merr gjithashtu edhe një libër shkolle të përshtatshëm.

4 Cila shkollë është e përshtatshme për fëmijën tim?

Fëmijët në moshën e arsimit të detyrueshëm

Shkolla fillore (VS)

6 deri në 10 vjeç

Klasa 1 deri në 4

Fëmijët e moshës 6 deri në 10 vjeç ndjekin për 4 vjet shkollën fillore. Kur një fëmijë gjashtëvjeçar nuk është ende i gatshëm për të filluar shkollën, ai pranohet në nivelin parashkollor. Pas kësaj, ai ka një vit kohë që të përshtatet me kërkesat e shkollës.

Shkolla e mesme e re (NMS)

Shkolla e mesme e orientuar (AHS) – cikli i ulët

10 deri në 14 vjeç

Klasa 5 deri në 8

Pas shkollës fillore, fëmijët ndjekin për 4 vjet shkollën e mesme të re (NMS) ose ciklin e ulët të shkollës së mesme të orientuar (AHS). Fëmija që vjen në Austri në moshën 10 vjeç ose më shumë, pranohet menjëherë, sipas moshës, në NMS ose në ciklin e ulët të AHS-së.

NMS-ja duhet që t'i pranojë të gjithë nxënësit, por AHS-ja mund edhe t'i refuzojë fëmijët që aplikojnë.

Fëmijët që pas 4 vjetësh përfundojnë me sukses NMS-në ose ciklin e ulët të AHS-së, mund të vazhdojnë karrierën shkollore në një shkollë të arsimit të mesëm ose të ndërmjetëm.

Shkolla politeknike (PTS)

14 deri në 15 vjeç

Klasa 9

Fëmijët që nuk ndjekin shkollën e mesme, e përbushin detyrimin shkollor në PTS ose në një shkollë njëvjeçare për ekonomi shtëpiake. Në këtë vit të fundit të arsimit të detyrueshëm, nxënësit dhe nxënëset përgatiten për jetën profesionale.

Arsimi i specializuar

6 deri në 15 vjeç

Klasa 1 deri në 9

Në konsideratë merren edhe fëmijët në moshën e arsimit të detyrueshëm, të cilët kanë **nevoja të veçanta pedagogjike** (p.sh. fëmijët e verbër ose që nuk dëgjojnë). Ata mund të ndjekin një shkollë speciale ose, në varësi nga moshja, të ndjekin shkollën fillore, shkollën e mesme të re, ciklin e ulët të një shkolle të mesme të arsimit të orientuar, shkollën politeknike ose shkollën njëvjeçare për ekonomi shtëpiake.

Pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm ekzistojnë këto mundësi:

Shkolla profesionale dhe praktika mbi 15 vjeç

Pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm (9 vjet), të rinjtë mund të arsimohen për një profesion. Ata duhet të gjejnë një ndërmarrje që t'i pranojë ata si praktikantë, dhe në të njëjtën kohë të ndjekin shkollën profesionale. Kjo zgjat pothuajse për aq kohë sa zgjat edhe praktika në punë (2 deri në 4 vjet). Në shkollën profesionale, aftësitë praktike të fituara në fabrikë plotësohen me njohuri teorike. Provimi për përfundimin e praktikës jep të drejtën për ushtrimin e profesionit të mësuar. Në Austri ofrohet mësimdhënie për rreth 200 profesione.

Azilkërkuesit në moshë të re mund të fillojnë një praktikë në punë vetëm në një të ashtuquajtur profesion me mungesë kapacitetesh njerëzore. Kjo do të thotë profesione, të cilat kanë nevojë urgjente për forcë punëtore.

Shkollat pasuese

Shkollat pasuese nuk duhet t'i pranojnë aplikantët. Për pranimin e tyre vendos drejtori/ drejtorja e shkollës. Për këtë arsye, të rinjtë që nuk janë në moshë arsimit të detyrueshëm shpesh nuk e kanë të lehtë të vazhdojnë edukimin nga vendi i tyre i origjinës, para së gjithash kur nuk zotërojnë akoma gjuhën gjermane. Por në parim, pranimi në shkollat pasuese është i mundur duke i konsideruar ata si nxënës jo të zakonshëm. Nëse keni dëftesa nga vendi i origjinës, merrini ato me vete në kohën që shkoni për t'u regjistruar.

Shkolla e mesme e orientuar (AHS) – cikli i lartë 14 deri në 18 vjeç

Pas NMS-së ose ciklit të ulët të AHS-së, të rinjtë mund ta vazhdojnë karrierën shkollore në ciklin e lartë të AHS-së. AHS-ja ofron një arsim të përgjithshëm të mirë. Ajo zgjat 4 vjet dhe përfundon me provimin e lirim (matura). Kalimi në provimet e maturës të jep të drejtën për të vazhduar studimet në universitet, në shkollat e larta profesionale ose në shkollat e larta pedagogjike.

Shkollat profesionale

Ekzistojnë disa lloje të ndryshme shkollash, p.sh. në fushën e tregtisë, teknikës, të turizmit ose në fushën sociale.

Shkollat e ndërmjetme profesionale (BMS) 14 deri në 17 (18) vjeç

Shkollat e ndërmjetme profesionale (ose shkollat teknike) ofrojnë arsim të përgjithshëm dhe kualifikime profesionale. Ato zgjasin 3 ose 4 vjet dhe përfundojnë me dhënien e provimit përfundimtar. Pas kësaj mund të hyhet në jetën profesionale ose në një kurs studimesh plotësuese për përfundimin e ciklit të lartë të një shkolle të mesme profesionale.

Shkollat e mesme profesionale **14 deri në 19 vjeç**

Shkollat e mesme profesionale ofrojnë një formim profesional të nivelit të lartë dhe një edukim të përgjithshëm të thelluar. Ato zgjatin 5 vjet dhe përfundojnë me dhënien e provimit të liritimit dhe të diplomës. Kalimi i këtij provimi të jep të drejtën për të vazhduar studimet në universitet, në shkollat e larta profesionale dhe në shkollat e larta pedagogjike.



Erhältlich unter

www.schulpsychologie.at/bildungsinformation

auch in folgenden Sprachen:

Arabisch

Bulgarisch

Deutsch

Englisch

Farsi

Französisch

Rumänisch

Russisch

Somali

Tschetschenisch

Türkisch

Të dhënat e botimit

Zotëruesi i medias, botues dhe shpërndarës:

Ministria Federale e Arsimit

1010 Wien

Tel: +43 1 531 20-0

www.bmb.gv.at

Dizajni: BKA Design & Grafik

Printimi: One2print / DI Hans A. Gruber KG

Vjenë, 2016/17

Botimi i 2-të